



**SITUATA SHËNDETËSORE
E KOMUNITETEVE ASHKALI,
EGJIPTIAN DHE ROM
NË KOMUNËN E FUSHË
KOSOVËS DHE NDËRTESAVE
SOCIALE NË FSHATIN
PLEMETIN NË KOMUNËN
E OBILIQIT**

Kosana



**SITUATA SHËNDETËSORE
E KOMUNITETEVE ASHKALI,
EGJIPTIAN DHE ROM
NË KOMUNËN E FUSHË
KOSOVËS DHE NDËRTESAVE
SOCIALE NË FSHATIN
PLEMETIN NË KOMUNËN
E OBILIQIT**

DETAJET E PUBLIKIMIT DHE MIRËNJOHJET

04

Hartuar nga:

Muhamet Arifi (BSFK)

Ferdane Asllani (BSFK)

Ilir Hoxha (Solidar Suisse)

Mihane Nartilë Saliu Bala (Solidar Suisse)

Mundësuar nga

Solidar Suisse Kosova

Edituar nga

Ilir Hoxha

Dizajnuar nga

Zaim Zogaj (Solidar Suisse)

Vendi

Prishtinë, Kosovë

Data

Dhjetor, 2019



Balkan Sunflowers
Volunteers for Social Reconstruction



DETAJET E PUBLIKIMIT DHE MIRËNJOHJET	4
HYRJE	7
QËLLIMI	9
TË GJETURAT NGA STUDIMI	10
Informata të përgjithshme	11
Banimi	12
Kujdesi ndaj shëndetit	12
Personat me nevoja të veçanta	13
KËNAQSHMËRIA ME OFRIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE	15
Shërbimet publike të kujdesit shëndetësor të Kosovës (qendrat e mjekësisë familjare dhe spitalet)	16
Shërbimet publike të kujdesit shëndetësor të Serbisë (qendrat e mjekësisë familjare dhe spitalet)	16
Shërbimet në institucione private të kujdesit shëndetësor të Kosovës	17
SHËRBIMET PUBLIKE TË KUJDEMIT SHËNDETËSOR TË KOSOVËS (QENDRAT E MJEKËSISË FAMILJARE DHE SPITALET)	21
KONKLuzionET	23

HYRJE

Balkan Sunflowers Kosova (BSFK) dhe Solidar zbatojnë së bashku aktivitete në fushën e shëndetësisë që nga viti 2013. Ky studim është bërë në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta me qëllim të analizës së impaktit të projektit, krahasimit të situatës shëndetësore me vitin 2014, dhe njëkohësisht për të siguruar informata relevante për situatën shëndetësore dhe për të planifikuar aktivitete në këtë fushë në të ardhmen.

Në 2013-2014, Balkan Sunflowers Kosova (në tekstin e mëtejshëm BSFK) së bashku me Solidar Suisse zhvilloi një projekt hulumtimi mbi gjendjen shëndetësore të komuniteteve Ashkali, Egjiptian dhe Rom në Kosovë. Situata e dobët shëndetësore e tre komuniteteve është ndoshta rezultat i jetëgjatësisë së ulët të tyre. BSFK ka implementuar një studim shëndetësor me 393 familje romë, ashkali dhe egjiptianë. Sondazhi ishte krijuar për të mbledhur informacione mbi dhjetë fusha tematike që lidhen me shëndetësi. Kufizimet financiare zvogëlojnë ndjeshëm qasjen e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në shërbimin shëndetësor, e cila nga ana tjetër ndikon negativisht në shëndetin e tyre të përgjithshëm.

Hulumtimi i ri i implementuar gjatë muajit dhjetor të vitit 2019 kishte qëllim që të bëjë një krahasim të situatës me hulumtimin e vitit 2014. Shumica e pyetjeve të vitit 2014 u përsëritën, por njëkohësisht kemi pasur edhe disa pyetje të reja të cilat kanë dalë nga takimi që u mbajt me institucionet shëndetësore gjatë analizimit të pyetësorit të vjetër dhe finalizimit të pyetësorit të ri. Në hulumtimin e vitit të kaluar janë intervistuar 394 familje nga lokacione të ndryshme të Kosovës. Ky studim është fokusuar në dy lokacione në të cilat BSFK ka implementuar aktivitete të ndryshme për të ndikuar në përmirësimin e situatës shëndetësore të këtyre tri komuniteteve. Në këtë studim kemi përfshirë 502 familje me gjithsej 2850 anëtarë. Studimi është kryer në Komunën e Fushë Kosovës dhe në rrethinën e Ndërtesave Sociale në fshatin Plemetinë në Komunën e Obiliqit.

Pyetësi është implementuar nga 15 të rinjtë nga komunitetet Ashkali, Egjiptian dhe Rom të cilët jetojnë në këto dy lokacione. Të rinjtë kanë vizituar secilën familje nga këto lokacione dhe kanë arritur të intervistojnë 502 familje. Jo të gjitha familjet kanë pranuar të intervistohen për shkak që ka hulumtime të ndryshme nga akterë të ndryshëm dhe familjet rezistojnë të janë pjesë e hulumtimit.

BSFK nuk ka komentuar të gjitha të dhënat nga hulumtimi të paraqitura në këtë raport për shkak të afatit të shkurt kohor që kishim në disponim. Besojmë që një analizë specifike do të bëhet në vitin 2020.



QËLLIMI

Qëllimi i këtij raporti është që të analizohet situata shëndetësore e komuniteteve Ashkali, Egjiptian dhe Rom në Komunën e Fushë Kosovës dhe në lagjen e Ndërtesave Sociale në fshatin Plemetinë në Komunën e Obiliqit. Përmes këtij studimi do të krahasojmë situatën shëndetësore me raportin e vitit 2014, dhe do të vlerësojmë impaktin e aktiviteteve të ndryshme të implementuara nga BSFK me qëllim të përmirësimit të situatës shëndetësore të këtyre tri komuniteteve. Të gjeturat nga studimi do të përdorën për dizajnimin e aktiviteteve në të ardhmen.



TË GJETURAT NGA STUDIMI

INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Në hulumtim kemi përfshirë 502 familje. 432 familje nga Fushë Kosova dhe 70 familje që jetojnë në Ndërtesa Sociale dhe në afërsi të tyre në fshatin Plemetinë të Komunës së Obiliqit. 2850 persona ishin të përfshirë në hulumtim. Prej tyre 1535 (53.86%) ishin të gjinisë mashkullore dhe 1315 (46.14%) të gjinisë femërore. Numri i të intervistuarve sipas grup-moshave është elaboruar në tabelën e mëposhtme.

TABELA 1. Mosha e të intervistuarve sipas grup-moshave dhe gjinisë

MOSHA E TË INTERVISTUARVE SIPAS GRUP-MOSHAVE DHE GJINISË								
MOSHA	0-5	6-14	15-17	18-39	40-64	Mbi 65	Totali	%
FEMRA	181	285	127	428	256	38	1315	46.14
MESHKUJ	243	353	166	463	280	30	1535	53.86
TOTALI	424	638	293	891	536	68	2850	100

Në hulumtimin e vitit 2014 nuk janë evidentuar fëmijët nën moshën 12 vjeçare. 424 fëmijë janë të moshës 0-5 vjeçare dhe bazuar në këtë numër të lart (prej 14.88% të totalit) mund të konstatojmë se nataliteti është shumë i lartë në krahasim me komunitetet tjera që jetojnë në Kosovë. Duke marr parasysh që një prej kriterëve për të përfituar nga asistenca sociale është që familja të ka një fëmijë deri në moshën 5 vjeçare, mund të konstatojmë që njëra prej arsyeve të natalitetit të lartë është përfitimi i asistencës sociale. 75% e të intervistuarve janë të moshës 15 – 64 vjeçare. Krahasuar me hulumtimin e viti 2014 numrat nuk kanë ndryshime të mëdha. Vetëm 68 (2.39%) persona janë mbi moshën 65 vjeçare. Në hulumtimin e vitit 2014 kjo shifër ishte më e lart (4.3%). Këto statistika tregojnë që mosha mesatare e vdekshmërisë të këto tri komunitete është shumë e re.

502 familje janë intervistuar. 384 (76.49%) familje Ashkali, 76 (15.14%) familje Egjiptian, 36 (7.17%) familje Rom, dhe 6 (1.20%) familje nuk janë deklaruar. Nga 502 familje të intervistuar 46 (9.56%) persona nën moshën 18 vjeçare janë martuar në 5 vitet e fundit. Numri i të martesave të hershme është më i ulët krahasuar me hulumtimin e vitit 2014 ku 27.3% ishin martuar nën moshën 18 vjeçare. 26 persona nën moshën 18 vjeçare kanë pasur lindje në 5 vitet e fundit. Në 19 familje ka pasur lindje të një fëmije, ndërsa në 8 familje ka pasur lindje nga 2 fëmijë. Në total, nga kjo grup-moshë kanë lindur 35 fëmijë.

Nga numri i përgjithshëm i personave të moshës 18-64 vjet të cilët mund të punojnë; 28 (1.96%) persona janë të punësuar në sektorin privat, 3 (0.21%) janë të punësuar në sektorin publik, 48 (3.36%) persona janë të punësuar në OJQ, 151 (10.58%) persona angazhohen në punë të përkohshme (javore apo mujore); dhe 1197 (83.88%) persona kanë deklaruar që nuk punojnë. Bazuar nga të gjeturat e vitit 2014, numri i atyre që kanë deklaruar që janë të papunë është rritur për 15%.

Të gjithë personat (68) mbi moshën 65 vjeçare janë përfitues të pensionit. 31 persona kanë deklaruar që nuk kanë dokumente të regjistrimit civil. Dhe 88 (17.53%) familje kanë deklaruar që posedojnë librezë shëndetësore të sistemit të shëndetësisë të Serbisë.

Nga 502 familjet e intervistuar: 89.84% jetojnë në strehim të përhershëm; 6.57% jetojnë në shtëpi të huaj pa pagës; 2.59% jetojnë në shtëpi të huaj me pagës; dhe 0.99% janë të kthyer nga diaspora dhe komuna paguan strehimin. Migrimi ose zhvendosja ka ndodhur në 82 familje të intervistuar në 5 vitet e fundit.

Sa i përket kushteve të jetesës në të cilat jetojnë 502 familjet Ashkali, Rom, dhe Egjiptian, 38.65% të familjeve kanë ujë publik 24 orë, përderisa 61.35% nuk kanë; 29.48% kanë konfirmuar se uji është i pijshëm, ndërsa 70.52% e kanë mohuar atë. 72.91% të familjeve kanë bunar. 85.65% të familjeve kanë ujë të ngrohtë, përderisa 14.94% nuk kanë ujë të ngrohtë. 93.43% të familjeve kanë tualet brenda shtëpisë, 93.23% kanë banjo dhe 57.66% kanë tualet jashtë shtëpisë.

93.42% të familjeve kanë thënë se mbeturinat merren me rregull dhe vetëm 6.57% kanë thënë se mbeturinat nuk merren me rregull. Afër 80.48% të familjeve ka mbeturina industriale. 91.24% të familjeve kanë kanalizim funksional. Në 94.82% të rasteve ka qenë endacak në vendbanimin e të intervistuarve.

56.77% kanë ndriçim rrugorë dhe 43.23% nuk kanë ndriçim rrugorë. 91.63% kanë rrymë 220V për 24 orë, ndërsa vetëm 8.37% nuk kanë rrymë 220V për 24 orë. 87.05% të familjeve e kanë rrugën e asfaltuar dhe 93.23% të familjeve kanë internet.

Familjet e intervistuar ngrohen në shtëpi duke përdorur: dru (97.81%), thëngjill (58.57%), rrymë elektrike (5.58%), plin (0.40%), dhe ngrohje qendrore (1.99%). Shumica e familjeve kanë deklaruar që në përgjithësi kombinojnë shfrytëzimin e drurit dhe thëngjillit si lëndë djegëse për ngrohje. Duhet të potencojmë që një përqindje e madhe prej 58.57% të familjeve përdorin thëngjillin i cili ndikon negativisht në shëndetin e familjes, dhe njëkohësisht në ndotjen e ambientit ku jetojnë.

KUJDESI NDAJ SHËNDETIT

Nga 502 familje të intervistuar, 221 familje kanë deklaruar që kanë pasur informata për ofrimin e ligjëratave shëndetësore nga akterë të ndryshëm. Në pyetjen se sa ligjërata kanë ndjekur, nga 221 familje, 8.60% nuk kanë marr pjesë asnjëherë, 30.36% kanë marr pjesë vetëm 1 herë, 53.40% kanë marr pjesë 2-5 herë, dhe 17.64% kanë marr pjesë më shumë se 5 herë. Në pyetjen nëse familjet kanë pasur shërbime parandaluese të kujdesit shëndetësorë, nga 502 familje, 10.95% kanë pasur mamogram, 3.78% kanë pasur ekzaminime për kancer, 0.19% kanë pasur ekzaminime për sëmundjet e transmetueshme seksualisht dhe 85.05% nuk kanë pasur asnjë shërbim.

Bazuar në raportet paraprake¹ lidhur me imunizimin e fëmijëve, situata është shumë më e mirë. Nga 502 familje, 88.2% i kanë fëmijët të vaksinuar sipas kalendarit të rregullt, 7.2% i kanë të vaksinuar pjesërisht, dhe 4.6% nuk i kanë fëmijët të vaksinuar. Prej numrit total prej 2850 personave, 1495 persona janë mbi moshën 18 vjeçare. 773 burra (67.53%) dhe 221 gra (27.84%) persona konsumojnë duhanin. 283 (68.90%) familje kanë deklaruar që konsumojnë duhanin brenda shtëpisë.

Hulumtimi ka pas qëllim që të hulumtoj sëmundjet me të cilat ballafaqohen komunitetet Ashkali, Egjiptian dhe Rom. Sëmundjet e raportuara nga respondentët përfshijnë: hipertension (51.79%), sëmundje zemre (32.47%), bronhiti, astma (20.12%), diabeti (24.70%), veshkat (12.75%), epilepsia (2.39%), paraliza e trurit (1.39%), hepatiti (0.40%), kanceri (0.99%), dhe 27.89% nuk raportuan ndonjë sëmundje. 264 respondentë kanë deklaruar se sëmundjet e deklaruara janë diagnostikuar nga mjeku, përderisa 98 respondentë kanë deklaruar që sëmundjet nuk janë diagnostikuar nga mjeku. Në pyetjen se a marrin trajtim mjekësor, 221 respondentët kanë thënë po, 74 kanë thënë jo, dhe 67 kanë thënë ndonjëherë. Duke marr parasysh që situatë socio-ekonomike është shumë e pafavorshme, ne kemi pyetur respondentët a mund ta përballojnë koston financiare për trajtimet mjekësore. 57 prej tyre mund ta përballojnë koston financiare, 170 nuk mund ta përballojnë dhe 135 mund ta përballojnë ndonjëherë.

¹WHO, UNICEF, World Bank. State of the world's vaccines and immunization, 3rd edition. World Health Organization, 2009, http://whqlibdoc.who.int/publications/2009/9789241563864_eng.pdf.

PERSONAT ME NEVOJA TË VEÇANTA

Pasi që nuk ka informata të mjaftueshme për numrin e personave me nevoja të veçanta, ne kemi marr informata për disa kategori. Pasi që nuk janë intervistuar të gjitha familjet që jetojnë në lokacionet ku është kryer hulumtimi, nuk mund të themi që këta janë numra definitive. Nga 502 familje të intervistuar, 0.19% kanë në familje person të hendikepuar, 1.39% kanë të verbër, 2.39% kanë shurdhmemec, 1.79% kanë persona me psikoza, 0.19% kanë me paraliza dhe 94.02% nuk kanë persona me aftësi të veçanta në familje.



KËNAQSHMËRIA ME OFRIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE

Përmes këtij studimi kemi analizuar kënaqshmërinë e komuniteteve Ashkali, Egjiptian dhe Rom me ofrimin e shërbimeve shëndetësore nga institucionet shëndetësore të Kosovës, Serbisë, dhe po ashtu nga institucionet private. Po ashtu kemi krahasuar informatat me hulumtimin e vitit 2014. Duhet ta kemi parasysh që hulumtimi i vitit 2014 pasqyron pikëpamjet e disa komunave ndërkaj ky raport pasqyron informatat për dy lokacione. Informatat janë të elaboruar në tabelat e mëposhtme.



SHËRBIMET PUBLIKE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR TË KOSOVËS (QENDRAT E MJEKËSISË FAMILJARE DHE SPITALET)

TABELA 2. Kënaqshmëria me shërbimet publike të kujdesit shëndetësor të Kosovës

	E VËRTETË	E PAVËRTETË	NUK E DI
JEMI SHUMË TË KËNAQUR ME KËTO SHËRBIME	457 (91.04%)	37 (7.37%)	8 (1.59%)
JEMI SHUMË TË KËNAQUR ME KOMUNIKIMIN	465 (92.63%)	26 (5.18%)	11 (2.19%)
NUK JEMI DISKRIMINUAR ETNIKISHT	443 (88.25%)	45 (8.96%)	14 (2.79%)
NUK KEMI PAS NEVOJË TË JAPIM TË RYSHFET APO DHURATA	366 (72.91%)	107 (21.31%)	29 (5.78%)

Në raportin paraprak 80.1% e respondentëve kanë deklaruar se janë të lumtur me ofrimin e shërbimeve, ndërkaq në këtë studim ka ngritje në 91.04%. 7.37% nuk janë të kënaqur, dhe 1.59% janë përgjigjur me nuk e di. Përderisa në hulumtimin e kaluar 73.0% e respondentëve kanë deklaruar që janë të kënaqur me komunikimin e institucioneve shëndetësore, në këtë studim ka ngritje në pohim në 92.63%. 5.18% nuk janë të kënaqur dhe 2.19% janë përgjigjur me nuk e di.

Krahasuar me hulumtimin e vitit 2014 ku 84.60% e respondentëve kanë deklaruar që nuk janë diskriminuar në baza etnike, përqindja e respondentëve në këtë studim është 88.25%. 8.96% respondentë janë diskriminuar etnikisht, dhe 2.79% nuk e dinë nëse janë diskriminuar. 38.3% e respondentëve nga raporti i vitit 2014 kanë deklaruar që kanë dhënë ryshfet apo dhurata personelit shëndetësor. Në këtë hulumtim përqindja është 21.31%. 72.91% nuk kanë pas nevojë të japin ryshfet apo dhurata, dhe 5.78% janë përgjigjur me nuk e di.

SHËRBIMET PUBLIKE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR TË SERBISË (QENDRAT E MJEKËSISË FAMILJARE DHE SPITALET)

Krahasuar me 76.4% nga raporti i vitit 2014, 93.22% e respondentëve kanë deklaruar që janë të kënaqur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore, ndërsa 6.78% nuk janë të kënaqur. Në hulumtimin e vitit paraprak ku 85.5% e respondentëve kanë deklaruar që janë të kënaqur me komunikim, këtë vit përqindja është 74.58%. Ndërsa të pakënaqur janë 25.42%. Krahasuar me 85.5% të respondentëve që në vitin 2014 kanë deklaruar që janë të diskriminuar në baza etnike, në këtë vit është 84.75%, dhe 15.25% nuk janë diskriminuar etnikisht. 87.5% e respondentëve kanë deklaruar në vitin 2014 që kanë pasur nevojë të japin ryshfet. Këtë vit 67.80% kanë deklaruar që japin ryshfet, përderisa 32.20% kanë deklaruar se nuk japin ryshfet.

TABELA 3. Kënaqshmëria me shërbimet publike të kujdesit shëndetësor të Serbisë

	E VËRTETË	E PAVËRTETË
JEMI SHUMË TË KËNAQUR ME KËTO SHËRBIME	110 (93.22%)	8 (6.78%)
JEMI SHUMË TË KËNAQUR ME KOMUNIKIMIN	88 (74.58%)	30 (25.42%)
NUK JEMI DISKRIMINUAR ETNIKISHT	18 (15.25%)	100 (84.75%)
NUK KEMI PAS NEVOJË TË JAPIM TË RYSHFET APO DHURATA	34 (32.20%)	80 (67.80%)

SHËRBIMET NË INSTITUCIONE PRIVATE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR TË KOSOVËS

Pasi që nuk ka informata të mjaftueshme për numrin e personave me nevoja të veçanta, ne kemi marr informata për disa kategori. Pasi që nuk janë intervistuar të gjitha familjet që jetojnë në lokacionet ku është kryer hulumtimi, nuk mund të themi që këta janë numra definitive. Nga 502 familje të intervistuar, 0.19% kanë në familje person të hendikepuar, 1.39% kanë të verbër, 2.39% kanë shurdhmemec, 1.79% kanë persona me psikoza, 0.19% kanë me paraliza dhe 94.02% nuk kanë persona me aftësi të veçanta në familje.

TABELA 4. Kënaqshmëria me shërbimet private të kujdesit shëndetësor të Kosovës

	E VËRTETË	E PAVËRTETË	NUK E DI
JEMI SHUMË TË KËNAQUR ME KËTO SHËRBIME	368 (73.31%)	11 (2.19%)	123 (24.50%)
JEMI SHUMË TË KËNAQUR ME KOMUNIKIMIN	363 (72.31%)	15 (2.99%)	124 (24.70%)
NUK JEMI DISKRIMINUAR ETNIKISHT	246 (49.00%)	129 (25.70%)	127 (25.30%)



BSFK ka analizuar edhe arsyet pse qytetarët Ashkali, Egjiptian dhe Rom nuk vizitojnë institucionet shëndetësore. Përgjigjet e responentëve janë elaboruar në tabelën e mëposhtme. Krahasimi i pohimeve nga raporti i vitit 2014 është elaboruar në tabelë.

TABELA 5. Kënaqshmëria me shërbimet publike të kujdesit shëndetësor të Kosovës

	E VËRTETË	PJESËRISHT E VËRTETË	E PAVËRTETË	NUK E DI	POHIMI NGA RAPORTI I VITIT 2014 (%)
MJEKU ËSHTË SHUMË LARG	208 (41.43%)	123 (24.50%)	162 (32.27%)	9 (1.79%)	39.40
NUK KA TRANSPORT	229 (45.62%)	56 (11.16%)	204 (40.64%)	13 (2.59%)	37.20
NUK KEMI MUNDËSI PËR TA PAGUAR TRANSPORTIN	257 (51.20%)	138 (27.49%)	102 (20.32%)	5 (1.00%)	33.20
NUK KEMI MUNDËSI PËR TI PAGUAR SHPENZIMET E MJEKIMIT	254 (50.60%)	141 (28.09%)	102 (20.32%)	5 (1.00%)	42.40
GËZOJMË SHËNDET TË MIRË	285 (56.77%)	98 (19.52%)	116 (23.11%)	3 (0.60%)	50.80
NUK KEMI KOHË	36 (7.17%)	50 (9.96%)	412 (82.07%)	4 (0.80%)	13.30
ËSHTË KOHA E GJATË E PRITJES TE MJEKU	279 (55.58%)	124 (24.70%)	95 (18.92%)	4 (0.80%)	48.20
NUK I BESOJ MJEKËVE	50 (9.96%)	76 (15.14%)	372 (74.10%)	4 (0.80%)	13.70
PROBLEMI SHËNDETËSOR ËSHTË SHËRUAR VETVETIU	185 (36.85%)	85 (16.93%)	220 (43.82%)	12 (2.39%)	28.80
STAFI MJEKËSOR KA QËNDRIME DISKRIMINUESE NDAJ NEVE	18 (3.59%)	65 (12.95%)	387 (77.09%)	32 (6.37%)	9.6

Krahasuar me raportin paraprak ku 39.40% të respondentëve kanë pohuar se mjeku është shumë larg, këtë vit pohimi është 41.43%. 37.20% e respondentëve kanë deklaruar në vitin 2014 që nuk ka transport. Këtë vit 45.62% kanë deklaruar se nuk ka transport. Në raportin paraprak 33.20% kanë deklaruar që nuk kanë mundësi për ta paguar transportin, në këtë vit numri është rritur në 51.20% respondentë që nuk mundën ta paguajnë transportin, përderisa 20.32% kanë deklaruar se mundën ta paguajnë transportin

Krahasuar me 42.40% të respondentëve që në vitin 2014 kanë pohuar që nuk kanë mundësi për ti paguar shpenzimet e mjekut, në këtë vitë është 50.60% që e pohojnë këtë. Ndërsa 28.09% deklarojnë që kjo është pjesërisht e vërtet, 20.32% e mohojnë, dhe 1% janë përgjigjur me nuk e di.

Sa i përket shëndetit të mirë, në vitin 2014, 50.80% e respondentëve e kanë konfirmuar këtë, ndërsa këtë vit 56.77% kanë thënë se është e vërtet, 19.52% kanë thënë pjesërisht e vërtet, 23.11% kanë thënë se nuk gëzojnë shëndet të mirë, dhe 0.60% nuk e dinë. Në raportin paraprak, 13.30% respondentë pohuan se nuk kanë kohë, këtë vit pohimi është 7.17%, ndërsa 82.07% kanë konfirmuar se kanë kohë. Në vitin 2014, 48.20% e respondentëve pohuan se koha e pritjes te mjeku është e gjatë, ndërsa këtë vit 55.58% e pohuan këtë dhe 18.92% e mohuan. 13.70% e respondentëve nuk i besonin mjekëve në vitin 2014, ndërsa këtë vit ky numër është zvogëluar në 9.96%, përderisa 74.10% konfirmuan se ju besojnë mjekëve. Në raportin paraprak 28.80% kanë deklaruar se problemi shëndetësor është shëruar vetvetiu, ndërsa këtë vit 36.85% e kanë konfirmuar këtë, 16.93% kanë thënë se kjo është pjesërisht e vërtet, 43.82% kanë thënë se kjo nuk është e vërtet dhe 2.39% nuk e dinë nëse problemi shëndetësor është shëruar vetvetiu. Krahasuar me 9.60% nga raporti i vitit 2014, vetëm 3.59% e respondentëve kanë deklaruar që stafi mjekësor ka qëndrime diskriminuese ndaj tyre dhe 77.09% e kanë deklaruar se kjo nuk është e vërtet.



SHËRBIMET PUBLIKE
TË KUJDESIT
SHËNDETËSOR
TË KOSOVËS
(QENDRAT E
MJEKËSISË
FAMILJARE DHE
SPITALET)

Në raportin e vitit 2014 kemi elaboruar që vdekshmëria mesatare në mesin e komuniteteve Ashkali, Egjiptian dhe Rom është 58.7 vjet. Në 502 familje kanë vdekur 56 persona në 5 vitet e fundit. Grup-mosha në të cilën vdekshmëria është më e lartë është 40-64 vjet, ndërsa grup-mosha me vdekshmëri më të ulët është 6-17 dhe 18-39. Grup-moshat 1-12 muaj dhe 1-5 vjet kanë vdekshmëri të njëjtë, nga 6 persona (10.71%), përderisa grup-mosha 40-64 ka 23 vdekje (41.07%).



KONKLUSIONET

Bazuar në të dhënat e mbledhura në 502 familje, shihet që situata e përgjithshme ka progres në disa fusha. Kënaqshmëria ndaj institucioneve shëndetësore është ngritur, diskriminimi është ulur, komunikimi në mes të qytetarëve nga këto tri komunitete dhe personelit shëndetësor është përmirësuar, dhe është ulur dhënia e ryshfetit. Po ashtu vetëdijesimi i tri komuniteteve rreth rëndësisë së investimit në parandalim të sëmundjeve është ngritur krahasuar me vitet paraprake.

Fatkeqësisht, nuk ka përmirësime të mëdha në përmirësimin e situatës shëndetësore, martesat e hershme dhe lindjet nën moshën 18 vjeçare janë ende të pranishme, nataliteti në ngritje, etj. Po ashtu nuk ka përmirësimin e kushteve dhe ambientin në të cilin jetojnë komunitetet Ashkali, Egjiptian dhe Rom. Bazuar në të dhënat BSFK do të vazhdoj me aktivitete shëndetësore për këto tri komunitete, duke u fokusuar më shumë në institucionalizim të aktiviteteve me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së rezultateve të pritura.



SITUATA SHËNDETËSORE E KOMUNITETEVE ASHKALI, EGJIPTIAN DHE ROM NË KOMUNËN E FUSHË KOSOVËS DHE NDËRTESAVE SOCIALE NË FSHATIN PLEMETIN NË KOMUNËN E OBILIQIT



Balkan Sunflowers
Volunteers for Social Reconstruction



SOLIDAR

FIGHTING FOR GLOBAL FAIRNESS